



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2023:242222

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05707148

P.nr.485/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN - Dega Viti, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas gjyqtares së vetme gjykuese Blerina Jakupi Ramadani, me bashkëpunëtorin profesional Fitim Limani, duke vendosur në çështjen penale të pandehurës A.S. nga fshati P.Komuna Viti, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8, lidhur me paragrafët 6 dhe 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i përgjithshëm PP.II.nr.1618/2023, e datës 24.11.2023, të cilën me autorizim e mbron av. Taulant Aliu nga Vitia, pas mbajtjes së seancës dëgjimore në lidhje me marrëveshjen për pranim të fajësisë të datës 15.05.2024, në të njëjtën datë mori dhe shpalli, ndërsa me datë 20.05.2024, përpiloi me shkrim, këtë:

A K T G J Y K I M

E pandehura **A.S.**, nga babai M. dhe nëna XH., e lindur H., e lindur me datë, në Gjilan, me vendbanim në fshatin P.Komuna Viti, ka të kryer fakultetin e infermierisë, e punësuar në në Viti, e martuar, e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, me numër personal

Ë S H T Ë F A J T O R E

Sepse me datë 08.10.2023, rreth orës 15:20, në rrugën “P.SH.” në fshatin S.P., – Komuna e Vitisë, e pandehura A.S., nga pakujdesia, ka rrezikuar trafikun publik duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, ashtu që: duke drejtuar automjetin e markës “F.P.”, me tabela të regjistrimit, ka vepruar në kundërshtim të dispozitës ligjore të nenit 53 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, në atë mënyrë që, derisa ishte duke lëvizur në rrugën aksin rrugor, me të arritur në rrugën “P.SH.”, duke mos i’ a përshtatur shpejtësinë e automjetit të saj, kushteve të rrugës (kthesë e thellë në të majtë), ka humbur kontrollin mbi drejtimin e automjetit duke dalur fillimisht jashtë rrugës në anën e majtë e më pas në anën e djathtë, ku edhe përfundon në një arë, me ç’rast shkakton vet aksident, me dëme materiale dhe lëndime trupore, ku lëndime të rënda trupore pëson, pasagjerja – e dëmtuara O.M., në formë të thyerjes së kockës kularthore të majtë, e shoqëruar me gërvishtje të lëkurës në kokë, e cila ka kërkuar ndihmë mjekësore në Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan-Emergjenca.

-me çka ka kryer veprën penale, Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafët 6 dhe 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 38, 39, 42, 43, 44, 69 dhe 70 të KPRK-së, lidhur me nenin 230 dhe 364 të KPPRK-së, të pandehurën A.S.:

E G J Y K O N

Për veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, të pandehurës A.S. i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh, i cili dënim do të ekzekutohet pasi ky aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm.

Konform nenit 44 të KPRK-së, dënimi me burg i zëvendësohet me dënim gjobë në shumë prej **700 (shtatëqind) euro**, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Dënimi me gjobë në vlerë prej 700 (shtatëqind) €, në bazë të nenin 43 paragrafi 2 të KPRK-së, do të paguhet në tre (3) këste mujore. Kësti i parë në shumë prej 250 (dyqindë e pesëdhjetë)€, të paguhet në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, kësti i dytë në shumë prej 250 (dyqindë e pesëdhjetë)€ të paguhet nga data 1-5 të muajit vijues pas pagesës së kështit të parë dhe kësti i tretë në shumë prej 200.00 (dyqind)€ të paguhet nga data 01-05 të muajit vijues pas pagesës së kështit të dytë. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan kështin me kohë.

Nëse e pandehura nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën, atëherë gjykata do t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë në dënim me burgim, ashtu që 1 (një) ditë burgim do të barazohet me 20 (njëzet) € të dënimit me gjobë.

E dëmtuara O.M., nga fshati P.Komuna Vitisë për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Konform nenit 449 parag. 4 të KPPRK-së, Refuzohet propozimi i prokurorisë i shënuar në aktakuzë që të pandehurën ta urdhërojë në pagimin e shpenzimeve procedurale: për ekspertizë mjekoligjore dhe ekspertizën e komunikacioni pasi që në shkresat e lëndës nuk është bashkangjitur faturë për pagimin e ekspertit që përcakton vlerën e pagesës, ndërsa organi që zbaton procedurën detyrohet të shënojë të gjitha shpenzimet e parapaguara në listën e cila i bashkangjitet shkresave të lëndës.

Obligohet e pandehura që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20€ (njëzet) dhe shumën prej 20€ (njëzet) euro për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

1.Rjedha e çështjes

Prokuroria Themelore nga Gjilani, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 24.11.2023 ka dorëzuar në Gjykatën Themelore në Gjilan, dega në Viti aktakuzën PP.II.nr.1618/2023, e datës 24.11.2023, kundër të pandehurës A.S. nga fshati P.Komuna Viti, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8, lidhur me paragrafët 6 dhe 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Me datë 15.05.2024 është mbajtur seanca dëgjimore në lidhje me marrëveshjen për pranim të fajësisë, në të cilin kanë prezantuar prokurorja e shtetit Iliriana Haziri Kryeziu, e pandehura A.S. dhe mbrojtësi i saj me autorizim av. Taulant Aliu.

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i përgjithshëm me datë 04.12.2023, në Gjykatë ka dorëzuar Marrëveshjen mbi Pranimin e Fajësisë PP.II.nr. 1618/2023, të datës 01.12.2023, të arritur në mes të Prokurorisë Themelore në Gjilan, të pandehurës dhe mbrojtësit të saj, sipas së cilës marrëveshje, gjykatës i është rekomanduar që të pandehurës për veprën penale nga dispozitivi i këtij aktgjykimi ti shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh, i cili dënim do të ekzekutohet, pasi aktgjykimi të bëhet i plotëfuqishëm. Gjithashtu, sipas kësaj marrëveshje, me pëlqimin e të pandehurës dhe konform nenit 44 të KPPRK-së, dënimi i shqiptuar me burgim i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej shtatëqind (700) euro dhe në seancën dëgjimore të marrëveshjes së pranimin të fajësisë të mbajtur me datë 15.05.2024, prokurorja e shtetit, e pandehura dhe mbrojtësi i saj kanë mbetur në tërësi pranë të njëjtës.

2. Vlerësimi i marrëveshjes për pranimin të fajësisë

Gjykata, me datë 15.05.2024 ka mbajtur seancën dëgjimore lidhur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë, në të cilën kanë qenë prezent prokurorja e shtetit Iliriana Haziri Kryeziu, e pandehura A.S. dhe mbrojtësi i saj me autorizim av. Taulant Aliu, ku pas dëgjimit të palëve gjykata ka marrë aktvendim me të cilin ka aprovuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë në bazë të nenit 230 paragrafi 20, lidhur me paragrafi 17 të KPPRK-së. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë e arritur mes Prokurorisë Themelore në Gjilan si dhe të pandehurës të lartcekur, i përmbush të gjitha kushtet ligjore si dhe e njëjta është arritur në bazë të nenit 230 të KPPRK-ës, po ashtu gjyqtarja e vetme gjykuese ka konstatuar faktin se pranimi i fajësisë mbështet në faktet dhe provat materiale të rastit konkret të cilat paraqiten në aktakuzë si dhe nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara nga neni 244 të KPPRK-ës.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtarja e vetme gjykuese vërtetoi këtë gjendje faktike: se e pandehura A.S. ka kryer veprën penale: rrezikim i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8, lidhur me paragrafët 6 dhe 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në vendin dhe mënyrë e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit ka vlerësuar që të pandehurës ti shqiptohet dënim të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase duke i marr parasysh të gjitha rrethanat dhe provat që gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesës. Gjithashtu gjykata, me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që posaçërisht rrethanë lehtësuese ka marrë faktin se e pandehura ka arritur marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë në Prokurorinë Themelore në Gjilan, ka shprehur keqardhje për rastin e ndodhur dhe është penduar, ndërsa si rrethanë rëndësuese gjykata mori parasysh peshën e veprës penale, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, andaj edhe mbi të lartcekurat gjykata konsideron se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurës, duke i marrë parasysh rrethanat e përmendura si më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurës.

5. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurës dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurës duke i marr parasysh rrethanat e lartpërmendura është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, me mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe shkallën e përgjegjësisë së saj. Gjykata, po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së.

6. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike

Gjykata në bazë të nenit 462 paragrafi 3 të KPP-së, të dëmtuarën O.M., nga fshati P.Komuna Vitisë për realizimin e kërkesës pasurore juridike e ka udhëzuar në kontest të rregullt juridiko civil.

7. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të pandehurës gjyqtarja e vetme gjykuese duke u bazuar në nenin 452 parag.1 të KPP-së ka vendosur që të pandehurën ta obligojë t'a paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet) euro, dhe shumën prej 20 (njëzet) euro për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Konform nenit 449 parag. 4 të KPPRK-së është refuzuar propozimi i prokurorisë i shënuar në aktakuzë që të pandehurin ta urdhërojë në pagimin e shpenzimeve procedurale: për ekspertizë mjekoligjore dhe ekspertizë të komunikacionit pasi që në shkresat e lëndës nuk është bashkangjitur faturë për pagimin e ekspertit që përcakton vlerën e pagesës, ndërsa organi që zbaton procedurën detyrohet të shënojë të gjitha shpenzimet e parapaguara në listën e cila i bashkangjitet shkresave të lëndës.

Nga të cekurat më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - Dega VITI
Departamenti i përgjithshëm
P.nr.485/2023, me datë 20.05.2024

Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Blerina Jakupi Ramadani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.